Shaban Çupi

J A T A K Ë T E L I R I S Ë

(Islam Brava, Nazmi Brava, Rufat Brava, Halil Rogaqi, Shefket Thaçi, Ali Huneli)

Hani i Elezit

2014

Shaban Çupi:
Jatakët e lirisë

Botues:
Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë e Sportit,
Hani i Elezit

Recenzentë: Emrush Dernjani

Lektor e korrektor: Akif Shkreta

:

2014

Parathënie

Ripushtimi i Kosovës nga Jugosllavia komuniste e Avnojit, ishte pushtimi i radhës i kësaj pjese të Shqipërisë etnike, e ndarë dhe e copëtuar nga Luftërat Ballkanike dhe të bekuara edhe me Konferencën e Ambasadorëve të Londrës në vitin 1913.

Ky ripushtimi i radhës, natyrisht se nuk u pranua nga popullata shqiptare, andaj në rrjedhë të kohës edhe u luftua me aq mundësi që kishte. Mjafton të përmendet rezistenca e organizuar atdhetare e Mulla Idris Gjilanit, Hysen Tërpezës, Sylë Hotlit, Hasan Remnikut, Gjon Sereçit, Marie Shllakut, Avdyl Durës, Azem Maranës, Xhemail Ferës, Qemal Skënderit e qindra e mijëra atdhetarëve të tjerë të cilët u dogjën e u poqën për një Shqipëri të bashkuar e të lirë.

Në kuadër të këtyre atdhedashësve ishin edhe *Jatakët e lirisë*, veprimtarë të trevës së Hanit të Elezit, të cilët me veprimtarinë e tyre ishin në krah të lirisë dhe të çlirimit të atdheut, andaj në vigjilje të 70 vjetorit të burgosjeve të tyre nga OZN-a jugosllave, nxorëm në dritë monografinë *Jatakët e lirisë*, vepër kjo e cila i kushtohet Islam Bravës, Nazmi Bravës, Rufat Bravës nga fshati Puset e Nikës si dhe

Halil Rogaqit e Ali Huneli nga fshati Rezhancë dhe Shefket Thaçit nga fshati Kryenik të komunës së Hanit të Elezit, të cilët në momentet më të vështira, strehuan dhe ndihmuan kaçakët, konkretisht kryengritësin Avdyl Durën me shokë.

Libri *Jatakët e lirisë* është i mbështetur në të dhënat arkivore, marrë nga Arkivi Shtetëror i Republikës së Kosovës si dhe nga burimet familjare, duke mos anashkaluar as burime të tjera shkencore të cilat u botuan nga autorë të ndryshëm.

Me librin monografik *Jatakët e lirisë* tentuam t`i arrijmë këto objektiva:

1.Të sheshojmë veprimtarinë e këtyre atdhetarëve, para nesh dhe gjeneratave që vijnë,

2.Të ndriçojmë këtë fazë të historisë sonë kombëtare në trevën e Hanit të Elezit,

3.Lexuesit dhe studiuesit shqiptarë dhe jo vetëm të tij, t`i afrojmë të dhëna arkivore për dënimet drakonike ndaj kundërshtarëve të pushtetit jugosllav,

4.T`i respektojmë dhe nderojmë të gjithë ata që luftuan për çlirimin e atdheut.

Në fokus të veprës vendosëm atdhetarin Nazmi Bravën e nëpërmjet tij, edhe veprimtarët e tjerë si; Islamin, Rufatin, Halilin, Shefketin e Aliun dhe veprimtarinë e tyre e mbështetëm në dokumentacion arkivor.

Jemi të vetëdijshëm se ndriçimi i plotë i veprimtarisë së këtyre atdhedashësve, përkundër shfrytëzimit të subjektit njeri dhe lëndës së tyre arkivore, mund të bëhet vetëm atëherë kur të kemi në dorë edhe segmentin tjetër domethënës, atë të dosjeve politike të UDB-së, të cilat i mungojnë Arkivit të Kosovës.
Megjithatë, monografia *Jatakët e lirisë* është edhe një fakt më tepër në rrugën e gjatë të lirisë dhe çlirimit të atdheut dhe ndjej kënaqësi që pata rastin dhe mundësinë të shkruaj për këta atdhetarë dhe çdo vërejtje të mundshme nga lexuesi e mirëpres.

Autori : Shaban Çupi,
Nëntor, 2013, Paldenicë - Hani i Elezit

Nazmi Brava[1] u lind në vitin 1896 në fshatin Puset e Nikës të komunës së Hanit të Elezit. U lind nga babai Rexhepi dhe nënë Havë, gjithnjë me shpresën se djali i sapolindur do ta kishte jetën më të mirë se paraardhësit e tij. U lind në shtrëngatat e asaj kohe e cila për shqiptarët ishte e rëndë, jo vetëm nga skamja dhe lufta me jetën, por edhe nga mungesa e lirisë dhe shtetit shqiptar i cili po kalonte shekujt nën pushtim.

Nazmi Brava u lind tri vite para se të formohej Lidhja Shqiptare e Pejës, kryesuar nga atdhetari Haxhi Zeka. Kur u hap Shkolla e vajzave në Korçë , Nazmiu kishte vetëm pesë vjet jetesë, ndërsa kur u mbajt Kongresi i Alfabetit Shqip në Manastir, ai mbushi 12 vite, por shkronjat shqipe nuk arriti t`i mësoj kurrë. Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë e gjen në moshën 16 vjeçare, ndërsa kur i mbushi 18 vite, pra në vitin 1914, serbët kolonizator të fshatit Guranë ia vranë babain Rexhepin. Nën flakën e këtyre ndodhive dhe kapërcejve të historisë, rritej e burrërohej Nazmi Brava. Nëpër odat e malësorëve, Nazmiu mësonte historinë shqiptare dhe nëpër këto oda, mësonte edhe për luftën e kaçakëve të cilët vinin fshehurazi dhe pasi siguronin bukën,

[1] Lënda e Nazmi Bravës,Rufat Bravës dhe Halil Rogaqit në Arkivin e Kosovës mban numrin P.nr. 15/48

shkepeshin maleve të Sharrit. Në shtëpinë e Nazmi Bravës gjatë kohës së krajlit pat qëndruar për një kohë edhe Sali Shabani nga Kabashi[2] , vrasës i gjaksorëve serb, Spirrë dhe Filë kapetanit . Kur u pre shpi për shpi Bllaca e Shkupit nga forcat partizane – çetnike serbe, Nazmiu do ta përjetoj rëndë dhe kjo do të mbetet ngjarja më e paharruar për vet Nazmiun dhe në përgjithësi për popullin shqiptarë të kësaj ane e më gjerë.

Pas martesës së Nazmiut me Sadiken, në vitin 1933 u lindi edhe fëmija i tyre i parë Minja dhe të tjerët me radhë: Salija, Havushja, Kadirja, Mexhiti dhe fëmijët të tjerë që do t`ia falte Zoti do të rriteshin si shqiponjat herë me prind e herë pa prind, herë me gëzime e më shumë me hidhërime, por megjithatë rronte e rritej kjo farë atdhetare buzë maleve të Sharrit.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Kosova ishte e ndarë në tri zona pushtuese: njërën pjesë (Mitrovicën) e kishin gjermanët, pjesën qendrore të Kosovës kishin italianët, ndërsa pjesën jug - lindore të Kosovës kishin nën zaptim bullgarët.

Pra treva e Hanit të Elezit ishte e pushtuar nga pushtuesi bullgar si aleat i gjermanëve. Krahas këtij

---

[2] Informatë nga Nuri Brava (1934), 4.10.2013, Puset e Nikës

pushtuesi, atdheun tonë përgatiteshin ta pushtonin edhe pushtues të tjerë, madje kësaj radhe pushtues me yll në ballë që nuk e njihnin as Zotin. Nazmi Brava, gjatë Luftës së Dytë Botërore, për një kohë do të veproj edhe në njësitë bullgare kontraçetnike, synimi i të cilave (edhe pse nën ombrellën e pushtuesit bullgar) ishte luftimi i këtyre bandave çetnike.
Nga ngjarjet e asaj kohe, familja e Nazmi Bravës kujton se gjermanët kishin zënë robër lufte një numër të madh njerëzish vendeve të ndryshme, të cilët i kishte ngujuar në vagonë të trenit dhe i dërgonte në kampet e tij. Kur treni u ndal në stacionin hekurudhor të Hanit të Elezit, nga treni i dëgjua një zë : A ka shqiptar që shpëton shpirt njeriu? Ishte Tefiku nga Shkodra një antifashist me gradën e kapitenit dhe kërkoi ndihmën e Nazmiut. Papritmas dhe me një guxim të papërshkruar, Nazmiu u tha gjermanëve që a më lejoni ta pushkatoj me duart e mia këtë robë (komunist) lufte? Pasi ata e lejuan, ai e mori Tefikun e nisi në drejtim të urës së Fezë Bushit dhe pasi shkrepi armën në ajr, u kthye te stacioni i trenit, ndërsa Tefikun e mori Islam Brava dhe e përcjelli andej Gërlicës ku ajo pjesë quhej Shqipni dhe e shpëtuan Tefikun. Pas LDB-së, Islam Brava shkoi në Shkodër

për të vizituar Tefikun ku edhe pritet me ngrohtësi nga Tefiku dhe familja e tij. Lidhjet me Tefikun nga Shkodra janë mbajtur edhe në vitet e 90-ta të shekullit XX, ku familjes Brava u dërgoi si peshqesh katër plisa të bardhë, plisa Shipnie.[3]

Fundi i vitit 1944 dhe 1945, Nazmi Bravën e gjen në Brigadat e Nacional Çlirimtares në ndjekje të fashizmit dhe në këto ndjekje, Nazmiu e vërtetoi se jeta e shqiptarit nën pushtetin komunist do të jetë edhe më e rëndë. Vrasja e shqiptarëve pas shpine nëpër frontet e luftës si në Tivar, Srem, Trogir e kudo tjetër, bënë që Nazmiu ta ndante mendjen se Jugosllavia e re e Avnojit s`është asgjë tjetër pos një varri i ri për shqiptarët, andaj që në fillet e saj e luftoi.



Shtëpia ku u lind dhe jetoi Nazmi Brava

[3] Informatë nga Nuri Brava (1934) dhënë autorit më 4.10.2013

Burgosja e ***Islam Bravës***[4] nga OZN-a jugosllave në vjeshtën e vitit 1946 dhe dënimi i tij në Gjykatën e Qarkut në Gjilan me vdekje-pushkatim, ishte një ngjarje e rëndë për familjen Brava. Islami, nga prokurori kuisling Ali Shukriu, akuzohej për rezistencë ndaj shtrirjes së pushtetit komunist në Kosovë dhe viset shqiptare, për luftën në Karadak të Shkupit dhe për disa vrasje që kishin ndodhur ndaj pesë serbëve të Shtërpcës në afërsi të Dheut të Bardhë, derisa ai kishte qenë kryetar komune në Han të Elezit. Por e vërteta e pashkruar në aktakuzë, ishte edhe fakti se familja Brava me pushtuesin serb ishte në ,,bela" që nga Serbia e Parë (1912- 1915), kur kolonët serbë të Guranës vranë Rexhë Bravën, xhaxhain e Islamit. Për këtë vrasje, familja Brava (Azemi e Islami) morën menjëherë gjakun e Rexhës, por Islami për dy vite me radhë detyrohet të jeton kaçak maleve dhe ,, i lirë" kthehet në shtëpi në kohën e pushtimit bullgar (1916-1918), ku me 20 lira turke paguajnë gjakun e Çavrës së plagosur, ndërsa gjaku i Velkos llogaritet kokë më kokë me atë të Rexhës[5]. Fakti tjetër është

---

[4] Lënda P.nr.10/47 Islam M. Muahrremi, bujk(1891), Pustenik, 29.11.1947, neni 3/3 LP (me pushkatim)
Shaban Çupi ,, Kush ishte Islam Brava" E vërteta, Shkup, 1997
[5] Shaban Çupi,,E vërteta" nr. 3, 1997,Shkup

ngjarja kur OZN-a duke kërkuar që të arrestoj Islamin, kishin marrë djalin e tij Muharremin dhe e dërgojnë në stacionin policor të Radushës, por Islam Brava duke ditur sherrin e serbëve kolonizator të Guranës (të cilëve u kishte ardhur dita për hakmarrje), futet në këtë fshat, shkon te shtëpia e Millçës dhe e kërcënon se, nëse deri në mëngjes nuk lirohet djali i tij Muharremi, do t`i kallë serbët në këtë fshat. Të nesërmen serbët detyrohen ta lirojnë Muharremin[6].

Kur u dënua Islami, në gjyq shkova unë dhe Hasip Brava, rrëfente për autorin e këtij libri, Zelfi Brava në vitin 1995 në Shkup. Islami ishte një burrë i gjatë, por edhe më të gjatë e bënin tirqit dhe xhurdia e veshur në gjykatoren e pushtuesit. Disi i ngjante Isa Boletinit. Në sallën e gjyqit u soll i lidhur me pranga në këmbë e duar.

Islam Brava ka pasur shumë miq, kujtonte Zelfiu. Ka pasur një rreth të gjerë shokësh e bashkë-veprimtarësh, ka qenë besnik dhe njeri me plot autoritet. Shokët e tij ishin nga Pollogu e Dërveni, Shkupi e Shkodra. Njihej mirë me Muharrem Fejzën[7] nga Hogoshti, Kadri Rakën, Ramë Bllacën, Lam Breznicën e Hysen Tërpezën, Xhemail Ferën

[6] Informatë nga Nuri Brava (1934) dhënë autorit më 4.10.2013

[7] I likuiduar në vitin 1945 nga OZN-a jugosllave

nga Bllaca e Shkupit[8]. Ismail Hoxha e emëroi kryetar komune në Han të Elezit gjatë vitit 1944 dhe njëkohësisht ishte pjesë e Shtabit të Rezistencës kundër forcave çetniko-partizane të udhëhequra nga Avdyl Dura të cilat zhvillonin luftën në Karadak të Shkupit dhe në këtë luftë iu vra djali 18 vjeçar Ademi[9].

Me kapitullimin e Bullgarisë dhe heqjes së postë-komandave ushtarake nga territori i Kaçanikut, u krijuan mundësitë për formimin e një pushteti popullor dhe njëherit për formimin e një batalioni shqiptar në krye me komandantin Avdyl Dura nga Durajt. Komandant shtabi ishte Islam Brava nga Pusteniku (Pusat e Nikës), ku qëllimi kryesor i këtij njësiti ushtarak shqiptar ishte mbrojtja e territorit të Kaçanikut, në Fushën e Shkupit e cila shtrihej përgjatë luginës së lumit Lepenc.[10]

Islam Bravën, e dënuan për gjithçka, rrëfente Zelfi Brava, madje edhe për vrasjen e 5 serbëve të Gatovushës së Shtërpcës, të cilat Islami i ka ditur, se kush i kishte vrarë, por kurrë nuk i tregoi

---

[8] Dosja politike e Xhemail Ferës në Arkivin Shtetror të Maqedonisë mban numrin 1082.

Shaban Çupi ,, Kush ishte Xhemail Fera" Radio Vati, Shkup, 1996

[9] Informatë nga Zelfi Brava, Shkup, 1995

[10] Ramadan Asllani ,, Avdyl Dura me bashkëluftëtarë për Shqipërinë Etnike" , Prishtinë, 1998, fq. 210-211

hetuesve të OZN-as, kujtonte Zelfi Brava, tani i ndjerë, duke shtuar se pas dënimit të Islamit, për të shpëtuar djalin Nejaziun dhe gruan e tij, Islami bën ,, shkurorëzimin'' me gruan dhe ata shpërngulen në Turqi.

Unë, thotë Zelfi Brava, kam ndjekur edhe gjykimin e atdhetarit Mulla Haki Sermaxhaj nga Hogoshti i Kamenicës në Gjilan. Atij prej torturave, iu kishte tharë krahu i majtë, por edhe trupin e kishte të vdekur pothuajse mbi 70%. E dënuan me 18 vite burg të rëndë. E di që disa vjet pas dënimit, ka vdekur në burgun e Mitrovicës së Sremit, dëshmonte Zelfi Brava në vitin 1995[11].

Edhe Lam Breznica, në Ditarin e tij, ndër të tjera shkruan se ,, Edhe me ballistat kemi pas lidhje në Kaçanik, me Avdyl Durën, Ramë Bekën,..., Islam Bravën", ndërsa Muharrem Fejza Nënprefekt i Kaçanikut, një pjesë të të hollave për mobilizim ushtarak ia jep edhe Islam Bravës.[12]

Kështu, falë syçeltësisë së Nënprefektit Muharrem Fejza dhe kryetarit të vullnetarëve kaçanikas, trimit Avdyl Dura, gjatë kohë, nga fundi i shtatorit deri në fundin e tetorit 1944, u pengua, me sukses të

---

[11] Vdes më 27 janar 1948 në burgun e Mitrovicës së Sremit

[12] Dr.Muhamet Pirraku,, Mulla Idris Gjilani dhe mbrojtja kombëtare e Kosovës lindore 1941-1951",Prishtinë 1995, fq. 183

plotë, kalimi i Brigadës I Proletare të Kosovë e Metohisë nga viset e Tetovës në Kosovë, në vise të Kaçanikut.[13]



NJEREZ DHE VEPRA

E VËRTETA NR.3

KUSH ISHTE ISLAM BRAVA

Trimi shqiptar Islam Brava u lind në fshatin Puset e Nikës të Hanit të Elezit (Kosovë). Më 1914 serëbët e fshatit Gorancë (fqinj) ia vrasin xhaxhain, Rexhë Bravën. Islami Bekën, Lam Breznicën, Muharrem Fejzën e shumë trima të tjerë.

Në vjeshtën e vitit 1946 arrestohet prej OZN – ës dhe pas gjashtë muajsh hetime të rënda në burgun e Gjilanit me pranga në duar e këmbë e nxjerrin para gjyqit, ku pro- më ç'njerëzore. Pas disa muaj hetimesh i nxjerrin para gjyqit me akuzë se kanë qenë bukëdhënës të "ballistëve" Avdyl Dura e Ramë Beka. Nazmi Brava dënohet me 6 vjet, Shefqet thaçi me 3 vjet dhe Ali Huneli me 6 muaj burgim.

Shaban Çupi ,, Kush ishte Islam Brava", pjesë nga një shkrim më i gjatë i botuar në revistën ,,E vërteta"nr.3, 1997, e cila botohej në Shkup, me kryeredaktor Fadil Curri.

Burgosja e Islam Bravës ishte një përjetim i rëndë për atdhetarin Nazmi Brava pasi që Islamin jo vetëm që e kishte të afërt e të gjakut, por me Islamin, Nazmiun e lidhte një veprimtari e gjerë e përbashkët atdhetare, sidomos lufta që u zhvillua në Karadak të Shkupit në vjeshtën e vitit 1944.

Nazmi Brava nuk ja kishte besën pushtuesit të ri. Gjellën e tij e kishte provuar edhe në Srem gjatë ndjekjes së fashizmit, andaj që nga burgosja e Islam

[13] Po aty fq. 182-183

Bravës, Nazmiu jetonte në strehimoren nëntokësore në vendin e quajtur Kallovë, afër stanit të tij në Puset e Nikës dhe kur futej dhe dilte nga strehimorja, ai ecte ujit të përroskës, ndërsa kur kishte borë kishte raste kur udhëtonte nëpër degët e lisave për të humbur gjurmët e strehimores, të cilat OZN-a ia kërkonte me ngulm. Nazmi Brava në strehimore dhe nëpër kodrat e Puseve të Nikës, kaloi rreth dy vite dhe njëkohësisht mbante lidhjet me kryengritësin e Durajve, Avdylin.[14]

Burgosja e Islamit, masakrat dhe tmerret që bënte pushtuesi sllavo-komunist në çdo shtëpi shqiptare dhe plot ngjarje të tjera si këto bënë që nga kjo kohë Nazmi Brava të kërkoj shkëndija lufte kundër pushtuesit jugosllav dhe kjo shkëndijë që synonte të bëhej një ditë një flakë e madhe, ishte dalja në mal e tribunit të Grykës së Kaçanikut, atdhetarit Avdyl Duraj me shumë shokë të tij si Ramë Beka e Sadik Tusha që me armë në dorë kishin vendosur luftimin e këtij pushtuesi famëkeq i cili për 50 vite me radhë do t`ua pinë gjakun shqiptarëve herë haptazi dhe shumë herë fshehurazi.

Vendosja e „ pushtetit popullor komunist ” në Kosovë e në këtë rast edhe në Kaçanik e Han të

[14] Informatë nga Nuri Brava (1934) ,më 4.10.2013

Elezit, ngriti struktura „ hyzmeqarësh" për mbrojtjen e „ fryteve të revolucionit të tyre" fryte të cilat shqiptarëve ua merrte edhe bukën e gojës nëpërmjet „ otkupit" shkatërrues dhe krahas kësaj edhe kërkimi i „kundërrevolucionarëve" dhe „ballistëve" në çdo shtëpi shqiptare. Në rrjedhë të kërkimit të këtyre armiqve kërkohej edhe Avdyl Dura me shokë, të cilët që në muajt e parë të „çlirimit" ishin arrestuar nga organet e pushtuesit jugosllav, por që një natë kishin arritur të ikin nga burgu dhe me një betim të prerë se të gjallë kurrë s`do të bien në duart e këtyre gjakpirësve, u ngjitën thepave, shpellave dhe grykave të Sharrit epik.
Të arratisurit në male, krahas pushkës dhe plumbit, natyrisht se kishin nevojën e përkrahjes nga njerëzit më besnik të popullit, kishin nevojë për individ që kishin besë e trimëri shqiptare pasi që çetat ndjekëse të OZN-ës përkatësisht të UDB-së, nuk linin birë e shteg pa kontrolluar e hetuar. Ata kishin nevojë për jatak, kishin nevojë të madhe për strehues dhe informues. Njëri nga ata i cili pranoi t`i del në ndihmë atdhetarit Avdyl Dura dhe shokëve të tij në ato ditë të vështira, ku krahas kaçakut dënim të ngjashëm merrte edhe jataku, ishte edhe Nazmi Brava. Ai me kënaqësi do të bëhet njëri nga jatakët e këtyre malësorëve

liridashës të cilët edhe pse të pashkollë, por të rryer e të gërryer nga jeta, herët kishin lexuar hilen e „bashkim-vllaznimit " të pushtuesit karshi popullit shqiptarë. Nazmi Brava me bukën e tij do t`i mban e ushqen kryengritësit shqiptar dhe në malet e Puseve të Nikës natën e ditën do t`i informon ata për ndjekjet që bënte UDB-a si dhe interesimin e madh të tyre për arrestimin e kaçakëve shqiptar të kryesuara nga Avdyl Dura. Nazmi Brava çdo herë dhe në çdo kohë do t`ju del në ndihmë këtyre kryengritësve dhe krahas kësaj do t`i ofron edhe jatak të tjerë besnik si Rufat Brava nga Puset e Nikës, Halil Rogaqin nga fshati Rezhancë dhe Shefket Thaçin nga fshati Kryenik të cilët për së afërmi i njihte edhe vetë Avdyl Dura. Këta jatak besnik për një kohë të gjatë do të mbeten kokat e lidhjes ndërmjet njësive kaçake-çlirimtare dhe masave të gjëra të popullit, derisa një ditë , siç thonë familjarët e tyre „ i dha dikush" .

Janari i vitit 1948, për fshatrat dhe banorët e kësaj ane shënonte një ditë tmerri. Njësi të tëra të UDB-së nisen në drejtime të ndryshme. Një pjesë u nis në drejtim të Puseve të Nikës dhe arrestojnë Nazmi Bravën e Rufat Bravën, një pjesë nisen në drejtim të Rezhancës dhe arrestojnë Halil Rogaqin, ndërsa pas

pak ditësh nisen në drejtim të Kryenikut dhe arrestojnë Shefket Thaçin.
3 janari i vitit 1948, Nazmi Bravën e gjen nën pranga të rënda në këmbë e duar në zyrat hetimore të UDB-së në Gjilan dhe siç dëshmojnë familjarët e tij, torturat ndaj Nazmiut kanë zgjatur natë e ditë madje shumë sish edhe i vjerrur me kokë poshtë. Për një vit me radhë i ka mbajtur prangat në këmbë[15]. Aleksa Vuqiniqi i quajtur „ Vuqa" ishte udbashi i cili i shkallmonte shqiptarët në këto zyre hetuese, ndërsa sllavokomunisti Ali Shukriu ishte prokurori i gjykatës armike i cili shprehte mllefin „juridik" mbi bashkëkombasit e tij, ndërsa gjykatësi rus Zaharije Orgjonikidze ua „prente'' teshat e robërisë shqiptarëve me pushkatim ose burg me dekada.
Kemi arritur që nga Arkivi Shtetëror i Republikës së Kosovës të sigurojmë lëndën e atdhetarit Nazmi Brava si dhe të anëtarëve të tjerë të grupit të dënuar, dokumente të cilat zbardhin në mënyrë shkencore veprimtarinë e këtyre liridashësve të viteve të 40-ta të shekullit XX, pjesë nga të cilat do t`i shkoqisim më poshtë:

[15] Informatë nga Zelfi Brava, 1995, Shkup

Në pyetjen e përgjithësuar të gjakpirësit Aleksa Vuqiniq, në zyret e UDB-së, Nazmi Brava përgjigjet:
Quhem Nazmi Brava, jam i lindur në vitin 1896 në fshatin Pustenik rrethi i Nerodimes,... dhe i martuar me Sadiken, me profesion jam bujk, analfabet, shqiptar, me gjendje të mesme ekonomike dhe deri më tani nuk kam qenë i dënuar.
Në kohën e ish Jugosllavisë, jam marrë me punimin e tokës, ndërsa nga viti 1942 kam shërbyer si kontraçetnik nën pushtimin bullgar për një vit të plotë.
Në pyetjen tjetër se A e njeh Avdyl Durën dhe nëse e njeh prej kur e njeh atë, Nazmi Brava përgjigjet:
Avdyl Durën nga fshati Duraj, i cili tani gjendet në arrati, e njoh që nga ish Jugosllavia sepse ka qenë kryetar i komunës së Sllatinës dhe më mirë e njoh gjatë kohës së okupimit(gjermano-bullgar) dhe gjatë asaj kohe kam qenë kontraçetnik, ndërsa ai ka qenë komandant dhe kemi pasur kontakte të përhershme.
A je takuar me Avdyl Durën prej se ka kaluar në arrati dhe nëse po, trego gjithçka çka din për atë?
Në muajin prill 1946 kam shkuar me Rufat Halilin nga i njëjti fshat që të marrim drunj në malin afër fshatit tonë. Kur kemi arritur në mal, nga mali ka

dalur Avdyl Dura dhe gjashtë të arratisurit e tjerë dhe nga të gjithë ata kam njohur Avdyl Durën, Sadik Tushën dhe Ram Bekën, ndërsa të tjerët nuk i kam njohur. Unë dhe Rufati me ata kemi qëndruar rreth dhjetë minuta dhe Avdyli na tha që të shkojmë në shtëpi dhe të marrim bukë dhe bashkë me Rufatin kemi shkuar në shtëpi dhe kemi sjellë bukë për të arratisurit. Avdyli na tha se për këtë takim nuk duhet t`i tregoni askujt dhe në anën tjetër na tha se kudo që të shkojmë me grupin, të na sjellni ushqim. Unë e Rufati u pajtuam me këtë dhe takimin me Avdylin nuk ia kemi treguar askujt. Të njëjtat tortura dhe të njëjtat pyetje kishin edhe ndaj të arrestuarve të tjerë si Halil Rogaqi, Rufat Brava e Shefket Thaçi të cilat do t`i pasqyrojmë si më poshtë:

Në pyetjen ndaj ***Halil Rogaqit***[16] se A e njeh Avdyl Durën, prej kur e njeh dhe na trego për bashkë-punimin tënd me atë, ai përgjigjet:

---

[16] 3 janari i vitit 1948, Halil Rogaqin e gjen të lidhur në pranga të OZN-as. Torturat ndaj tij, fillojnë që në Han të Elezit dhe te Ura e Fejzë Bushit e fusin në lumin Lepenc, dhe krahas torturës me ujë të ftohtë, ia thyejnë edhe krahun.Kjo ka ndodhur në janarin e vitit 1948, rrëfen Shaban Rogaqi, kujtime të cilat i mori nga (lokja) gruaja e Halilit, Sheqibja. Torturat tjera vazhdojnë në Ferizaj, për të përfunduar me plot tmerr në burgun e Gjilanit, ku krahas torturave tjera edhe e kastrojnë. Përkundër këtyre torturave, OZN-a nuk arrin

Avdyl Durën e njoh që nga koha e ish Jugosllavisë dhe e kam njohur si kryetar i komunës së Sllatinës në rrethin e Kaçanikut.
Nuk më kujtohet data e saktë, por më kujtohet që ka qenë dimër i vitit 1946 kur kam shkuar te Aziz Sinani në fshatin Kotlinë ku edhe kam buajtur. Në të njëjtën natë te Azizi, kanë ardhur Avdyl Dura e Din Hoxha me grupin e tyre nga mali. Këtu për herë të parë jam takuar me Avdyl Durën dhe është hera e parë që jam takuar pas arratisjes së tij. Kemi biseduar një kohë të shkurtë dhe ai më ka pyetur se si jetojmë dhe si qëndroni me pushtetin aktual. Ata kanë marrë ushqim te shoku im dhe shkuan. Unë për këtë takim nuk i kam treguar askujt. Herëve të tjera jam takuar kudo ku më ka kërkuar Avdyl Dura.

---

ta thyej Halilin, por ndërkohë, inskenohet një kurth i OZN-as dhe i bëjnë bashkë në një dhomë Nazmi Bravën, Halil Rogaqin dhe Rufat Bravën, pa e ditur këta se janë nën incizim të OZN-as, përkatësisht UDB-së. Halili u thotë shokëve të tij se meqenëse jeta imë ka përfunduar, më ngarkoni ju me veprat tuaja dhe unë në gjyq i pranoj të gjitha, por kur dalin në gjyq, vazhdon rrëfimin e tij Shabani, ju tregohet incizimi i bërë fshehurazi.

Një natë erdhi tek unë Nazmi Brava nga fshati Pustenik dhe më ka thënë se më kërkon Avdyl Dura në takim. Unë bashkë me Nazmiun kemi shkuar në malin e Pustenikut dhe kam takuar Avdyl Durën me grupin e tij Sadik Tushën, Isufin (mbiemri nuk më kujtohet) dhe një tjetër person të cilin nuk e kam njohur. Në këtë takim kemi qëndruar rreth dy orë dhe kemi biseduar për gjëra të thjeshta. Avdyl Dura dhe shokët e tij na kanë thënë se jeta në male është shumë e rëndë dhe ka kontroll shumë të madh...
Pos këtyre dy takimeve, herën tjetër me Avdyl Durën jam takuar në gushtin e vitit 1947. Edhe këtë herë ka ardhur Nazmiu dhe më ka ftuar për takim me Avdyl Durën dhe jemi takuar, në të njëjtin vend ku jam takuar herëve të tjera, në vendin e quajtur „ Kalovë". Në takim kanë qenë Avdyl Dura, Sadik Tusha, Isuf N. dhe pjesëtarin e katërt të këtij grupi nuk e kam njohur. Këtë herë me të arratisurit, takova edhe Rufat Bravën nga Pusteniku...
A keni për të thënë edhe diçka tjetër?
Sa kam qenë milic vullnetar, kam njoftuar Avdylin për lëvizjet e policisë dhe ushtrisë jugosllave e cila ka qenë në kërkim të tyre. Gjithashtu në këtë takim Avdyli më ka thënë që ta përshëndes Shefket Hajrullahun (Thaçin) nga fshati Krivenik, të cilat

përshëndetje edhe ia kam përcjellë Shefketit dhe ai ka falënderuar për këtë.
Pas kësaj deklarate, për të akuzuarin Halil Rexhepi (Rogaqi), Prokuroria Publike e Rrethit në Ferizaj, më 19.1.1948, ngritë aktakuzë për të akuzuarin Halil Rexhepi nga fshati Rezhancë, ku ndër të tjera thuhej se ka mbajtur takime të rregullta me grupin e të arratisurit Avdyl Dura, ka mbajtur mbledhje me ato, i ka njoftuar për ndjekjet që ka bërë pushteti popullor ndaj tyre dhe i ka strehuar. Gjatë vitit 1946 dhe 1947 ka mbajtur lidhje të vazhdueshme dhe ka qenë njeriu më i besuari i tyre dhe i ka njoftuar për lëvizjet e pushtetit popullor, ju ka ndihmuar në luftë kundër rregullimit kushtetues të Jugosllavisë me çka ka kryer vepër penale nga neni 3 pika 7 dhe 14 e kodit penal. Në kuadër të kësaj akuze, kërkohet që në shoshitjen kryesore, të akuzuarit t`i lexohet edhe vendimi i UDB-së i datës 12 janar 1948 si dhe vendimi i Këshillit Popullor të Vendit në Han të Elezit i datës 14 janar 1948 dhe krahas kësaj në fund kërkohet që Halil Rexhepin (Rogaqin) ta shpallë fajtor dhe ta dënon me dënim të rëndë.



Halil Rogaqi me nipërit e tij, fotografi e vitit 1965

Në procesverbalin e OZN-as të datës 3.1.1948 nga hetimet e zhvilluara ndaj Rufat Halilit (Brava) thuhet se:

Quhem ***Rufat Halili (Brava***) i lindur në vitin 1903 në fshatin Pustenik, rrethi i Nerodimes, nga babai Halil dhe nëna Beglije, me profesion bujk, shqiptar, analfabet, flas shqipen dhe serbishten, me gjendje ekonomike të varfër, deri më tani i padënuar.

Në pyetjen e përgjithësuar përgjigjet:

Gjatë tërë kohës së ish Jugosllavisë kam punuar në minierën e fshatit Radushë dhe në xeheroren e asbestit në fshatin Pustenik.
Ku ke qenë dhe çka ke punuar gjatë kohës së luftës?
Në zgjedhjet e fundit për organet e pushtetit popullor jam zgjedhur si këshilltar pranë Këshillit vendor në Han të Elezit.
Si, dhe kur je takuar me të arratisurin Avdyl Dura?
Nuk më kujtohet data e saktë, por mendoj se ka qenë muaji korrik i vitit 1947 kur në gjysmë të natës dikush ka trokitur në dyert e mia, deklaron Rufat Brava në zyret e UDB-së . Kur kam pyetur se kush është? Ai është përgjigjur se jam një njeri që shes duhan dhe më ka zënë nata. Unë hapa derën dhe vërejta një grup njerëzish e në mesin e tyre Avdyl Durën. Avdyli më kërkoi bukë, ndërsa unë nuk kisha bukë në shtëpi. Atëherë Avdyli më tha që ta lajmëroj Nazmi Bravën dhe të nesërmen të shkojmë për t`u takuar me atë dhe t`i sjellim bukën.
Unë gjatë asaj nate kam shkuar te Nazmiu dhe i kam thënë që të ka ftuar Avdyl Dura dhe të nesërmen duhet t`i dërgosh bukë. Të nesërmen unë kam shkuar te livadhi i cili ishte afër vendit ku më tha Avdyli dhe atje takova Nazmiun nga Pusteniku dhe Halilin nga fshati Rezhancë.
Çka ju pyeste tjetër Avdyli?

Pastaj Avdyli na ka pyetur se çka u bë me Islam Muharremin (Brava) nga fshati Pustenik i cili është i burgosur që në vitin 1946?

Ndërsa i burgosuri tjetër Shefket Thaçi, para OZN-as, përkatësisht oficerit hetues Vuqko, më 14 janar 1948, përgjigjet:

Quhem ***Shefket Hajrullahu (Thaçi***)[17] , jam i lindur në vitin 1917 në fshatin Krivenik nga babai Hajrullah dhe nëna Kadime, i martuar me Arzijen, jam babai i dy fëmijëve, di shkrim lexim, me gjendje të mesme ekonomike, në kohën e ish Jugosllavisë kam qenë i dënuar me një vit burg.

Gjatë kohës së ish Jugosllavisë kam qenë në shtëpi, përveç vitit 1937 ku kam qëndruar në burgun e Shkupit i dënuar me një vit burg si i dyshuar se kam vrarë një njeri nga fshati Glloboqicë, emri i të cilit nuk më kujtohet...

Pas kapitullimit të Jugosllavisë, kam shkuar në Shqipëri, sepse në trevën tonë u vendosën bullgarët. Në Shqipëri kam qëndruar derisa është çliruar Jugosllavia dhe gjatë tërë kohës kam jetuar në Lagjen e Teneqeve nr. 16. Gjatë tërë kohës sa kam qëndruar në Shqipëri, jam marrë me punë

[17] Lënda e Shefket Thaçit në Arkivin e Kosovës mban numrin P.nr.28/48


bujqësie dhe tregti dhe kam banuar te Rexhep Ahmeti në Tiranë.

Pas çlirimit të Jugosllavisë, e në këtë rast edhe të Kosovës në vitin 1944, kam ardhur në fshatin tim në Krivenik dhe menjëherë jam lajmëruar si vullnetar në LNÇ dhe jam sistemuar në Brigadën e Parë sulmuese të Brigadës XII të Divizionit IV të ushtrisë jugosllave në Knin të Dalmacisë[18]. Në ushtri kam qëndruar 18 muaj dhe kam qenë komandant i një çete dhe jam demobilizuar si i moshuar.

Pas arritjes në shtëpi nga ushtria jugosllave, si oficer i demobilizuar, jam pranuar në pushtetin popullor si këshilltar në Këshillin e Vendit dhe kam qenë më shumë se një vit këshilltar i pushtetit popullor, ndërsa në tetor 1947 përsëri kam

[18] Shefket Thaçi ishte edhe dëshmitar i mbytjes në ujë, në prillin e vititi 1945, të 29 ushtarëve të mobilizuar në ndjekje të fashizmit, nga komuna e Kaçanikut, prej të cilëve 14 të vrarë ishin nga treva e Hanit të Elezit: Bajram Bushi, Pustenik, Sabri Bushi, Pustenik, Ahmet Dernjani, Paldenicë, Jashar Dernjani, Paldenicë, Beqir Çupi, Paldenicë, Haziz Çupi, Paldenicë, Hamdi Topojani, Topojan, Haziz Berisha, Guranë, Kasum Berisha, Guranë, Fetish Berisha , Guranë, Xhemal Kryeziu, Guranë, Nazmi Huneli, Rezhancë, Riza Xhoni, Rezhancë, Nevaip Qajani, Kryenik, rënë në Trogir të Kroacisë. Varreza kolektive e 29 martirëve gjendet në varrezat e qytetit të Trogirit dhe autori i këtij libri e ka vizituar atë në vitin 1983.

kandiduar dhe sërish jam zgjedhur si këshilltar në Këshillin e Vendit në Han të Elezit.



Në 17 [illegible] të vitit 1941 [illegible] në teritorin e [illegible] [illegible]

[illegible] ne vendi [illegible] [illegible] [illegible] [illegible]

[illegible] në Shqipni.[illegible] [illegible] [illegible] [illegible]

menjiherë [illegible] [illegible] [illegible] [illegible]

[illegible] nji [illegible].

[illegible] nji [illegible] [illegible] [illegible]

[illegible] Sulë [illegible] i [illegible], [illegible] kishte edhe dy [illegible] [illegible]

[illegible] [illegible] [illegible], ku ka qenë edhe [illegible].

Prej andej kam shkue në vendin e quejtun [illegible] në

Pesë, aty gjindej nji vend i [illegible] [illegible]. Në Pesë si [illegible]

i [illegible] ishte Kaja, Zajë dhe Dakiu.

Përveç këtyne atje gjindeshin edhe [illegible] [illegible], Sulë [illegible],

Pepa e të tjerë, emnat e të cilëve nuk i mbaj mend. Shokët e [illegible]

ndum i gjeta në disa vende [illegible], në [illegible] ishte katundi Krum. [illegible]

këta shokë kam ndejtë nji kohë të gjatë si roje në katundin Krum, ku i

prîtshim Italianët.

Prej atij vendi kemi [illegible] në Labinot, ku u formue konferenca e

Labinotit.

Prej 17 Majit të vitit 1941 e deri në 5 Nandor të vitit 1943

kam qenë në teritorin e Shqipërisë, kurse prej 5 Nandorit të vitit 1943

jam përzie me "Gordanska Brigadën" të Vlladimir Gordanit.

Si dëshmitarë të kësaj janë edhe Kaja i Shyqiri Pesës, Zaje dhe

Dakiu.

Në bazë të fakteve të naltpërmendune Ju lus që të më vërtetoni

se prej 17 Majit të vitit 1941 e derin në 5 Nandor të vitit 1943 kam

qenë në teritorin Tuej.

Ju baj të fala shkelqencës Tuej dhe Ju lutem të më përgjigjeni se

ma shpejt, sepse kjo asht letra e katërt që Jua dërgoj e asnji përgjigje

nuk kam marrë.

Shefket Hajrulla Thaçi

Rruga "128" Nr.30

S H K U P

Faksimil i letrës që dëshmon qëndrimin e Shefketit në Shqipëri prej 17.5.1941 – 5.11. 1943[19] *dhe pjesëmarrja e tij në luftën antifashiste*

[19] Ramadan Asllani ,, Avdyl Dura…" Prishtinë 1998, fq.324

Në pyetjen e inspektorit të OZN-as se A e njeh Avdyl Durën dhe si e njeh atë, Shefket Thaçi përgjigjet:
Avdyl Durën nuk e kam njohur gjatë ish Jugosllavisë, as gjatë kohës së okupimit. Me atë njihem që nga koha që ka kaluar në arrati dhe atë nga shkurti i vitit 1947, disa ditë pas luftës që ka zhvilluar Avdyl Dura me grupin e tij në fshatin Strazhë ku edhe u plagos nëntogeri i UDB-së Ilija Hovjecki. Atë natë grupi ka ardhur te mulliri im, i cili gjendet në mes të Krivenikut dhe fshatit Radushë. Avdyl Dura e ka dërguar mulligjiun tim Avdyl Muratin nga fshati Kotlinë, që të vijë te shtëpia ime dhe më ftoi që të shkoj në takim me Avdyl Durën. Kur shkova atje, kam njohur vetëm Avdyl Durën. Ai më tregoi se ka zhvilluar një luftë në fshatin Strazhë dhe tani kemi ardhur në terrenin tuaj dhe më kërkoi që të siguroj ushqim për grupin. Nga mulliri im ata morën rreth 100 kg. miell.
Ku shkuan të arratisurit pastaj?
Grupi i të arratisurve, prej mullirit tim kanë shkuar në stanin e Zeqir Arifit në Krivenik dhe atje kanë qëndruar katër ditë... Pastaj kanë shkuar te Halil Rexhepi në fshatin Rezhancë ku kanë marrë bukë e duhan... Gjithashtu, siç më ka thënë Halil Rexhepi, ata kanë qëndruar edhe në fshatin Kotlinë te një

shok i Halilit. Pas këtij takimi, nuk jam takuar më me grupin e të arratisurve.
Sa anëtarë kishte grupi?
E di që ka qenë Avdyl Dura, Ram Beka, Sadik Tusha dhe përveç këtyre kanë qenë edhe gjashtë të tjerë të cilët nuk i kam njohur. Kanë qenë gjithsejtë nëntë...
A i ke treguar ndokujt për takimet me grupin e arratisur dhe lëvizjet e tyre?
Për takimet e mia me Avdyl Durën dhe grupin e tij si dhe për lëvizjet e tyre, nuk i kam treguar askujt edhe pse kam qenë këshilltar i fshatit.
Më 28 shkurt 1948, Prokuroria Publike e Rrethit në Ferizaj, për të akuzuarin Shefket Hajrullahu ngritë Aktakuzë, në të cilën thuhet:
Shefket Hajrullahu, bujk nga fshati Krivenik, Këshilli Popullor i Vendit në Han të Elezit, rrethi i Nerodimes, i lindur më 1917 nga babai Hajrullahu dhe nëna Kadime, i martuar, baba i dy fëmijëve, shqiptar, i përkatësisë islame, shtetas i Jugosllavisë, me gjendje të mesme ekonomike, i dënuar gjatë ish Jugosllavisë me një vit burg për vrasje, në burg nga data 14 janar 1948.
Sepse, si anëtar i Këshillit Popullor të Vendit në Han të Elezit, për një kohë të gjatë ka mbajtur lidhje të ngushta me grupin e të arratisurve në krye me

Avdyl Durën, i ka ndihmuar materialisht, i ka ndihmuar dhe ka marrë pjesë në mbledhjet e tyre, ka ditur për qëndrimi dhe lëvizjet e tyre dhe si anëtar i Këshillit Popullor ka qenë i obliguar t`i ndjek dhe t`i zbuloj, ndërsa ai përkundrazi, i ka ndihmuar dhe ju ka shërbyer si strehues (jatak). Ai në datën e pavërtetuar të muajit shkurt 1947 e ka pranuar të arratisurin Avdyl Dura dhe me atë ka mbajtur mbledhje dhe nga mulliri i tij i ka dhënë 100 kg. miell si dhe nuk ka lajmëruar askënd nga organet e pushtetit, për këtë ka kryer vepër penale të strehimit e paraparë nga neni 3 pika 14 e Kodit penal dhe e dënueshme nga neni 4 e po të njëjtit ligj... duke e porositur Gjykatën e Qarkut në Gjilan që Shefketin ta dënoj sa më rëndë dhe të merr dënimin e merituar.

Me këto pyetje dhe kërkesa të ngjashme, jatakët e lirisë dhe të çlirimit do të përballen me ditë dhe net të tëra, derisa një ditë i nxjerrin pranë Gjykatës së Qarkut në Gjilan dhe i dënojnë me dënime të rënda:

Nazmi Brava nga Puset e Nikës u dënua me vdekje-pushkatim, dhe humbjen e të gjitha të drejtave qy-tetare,

Rufat Brava po nga Puset e Nikës u dënua me 5 vite burg, dhe humbjen e të drejtave qytetare,

Halil Rogaqi nga fshati Rezhancë u dënua me 5 vite

burg, dhe humbjen e të gjitha të drejtave qytetare, Shefket Thaçi i dënua me 3 vite burg, dhe humbjen e të gjitha të drejtave qytetare.

Është me rëndësi të theksohet së Nazmi Brava, Rufat Brava e Halil Rogaqi u dënuan në një grup, ndërsa Shefket Thaçi në një proces gjyqësor të veçantë.

